REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
KËSHILLI I BASHKISË

Nr 5228 Prot Maliq, më 01.09.2026

VENDIM

Nr.104, datë 01.09.2026

"Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Maliq, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës financiare të menjëherëshme për familjen e z.Llambi Saro banesa e të cilit eshtë dëmtuar si rezultat i rënies së zjarrit. Ndihma financiare do të mbulohet nga buxheti i Bashkisë, zëri "*Mbrojtja Civile*"

Bazuar në ligjin.nr.139/2015 datë 17.12.2015, "*Për vetëqeverisjen vendore*",i ndryshuar, neni 8, neni 9, pika 1, nënpika 1.1, gërma "b", ligjin.nr.45/2019 datë 18.07.2019 "*Për mbrojtejn civile*" neni 30, gërma "gj", neni 41 pika 2.3,VKM-në nr.329 datë 16.05.2012 "*Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimataria njerzore*", Kreu III pika 1-Proceduarat e vlersimit të dëmeve gërma "a" dhe "ë", pika 3 gërma "a" për rënien e zjarrit në banesen e shtetasit Llambi Saro, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

1-Të miratojë një ndihmë financiare prej **580.000** lekë, për familjen e **z.Llambi Saro** të cilës i'u dogj banesa në datën 05.07.2026.

2-Vlera e plotë e shkatuar në banesë nga ana ndërtimore sipas komisionit të ngritur për këtë qëllim është 909,883.09 lekë.

3-Vlrea prej 50% për tu mbuluar nga ana e Bashkisë Maliq është 454.916 lekë.

4-Vlera e dëmeve në pajisje dhe orendi elektroshtëpiake sipas komisionit është 125,000 lekë.

5-Vlera e totale për tu dëmshpërblyer (454,916+125,000) është 579.916 lekë.

6-Pagesa të bëhet nga fondi "*Mbrojtja Civile në Bashki*", si më poshtë:

Gr	Kap	Kod. Prog	Llog.Eko	
17	01	10910	604	580.000 lekë

7-Për zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashki dhe Sektori i Emergjencave Civile

8-Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të piks 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" i ndryshuar.

Miratuar me 16 vota
Vota Pro 16
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 01.09.2026

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ